



EC
MA NDËRSHË

HUMAN RIGHTIVISM

“Manual për promovimin,
vullnetarizmin dhe përfshirjen e
të drejtave mjedisore dhe të
drejtave të njeriut në iniciativat
rinore”

Dhjetor 2023

Aktivizmi për të drejtat e njeriut

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &

Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.77

www.ecmandryshe.org , info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Dokumenti "Manual për promovimin, vullnetarizmin dhe përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore" është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

2023



Sweden
Sverige



Përmbajtje

Hyrje - Qëllimi dhe metodologjia e hartimit të udhëzuesit.....	5
Qëllimi dhe objektivat e udhëzuesit	5
Metodologjia	5
Tematikat.....	6
1.0. Përshkrim i projektit dhe objektivave të tij; grupeve të targetuara dhe synimit të përgjithshëm	8
1.1. Statistikat nga aktivitetet	9
2.0 Të drejtat e njeriut dhe aktivizmi	11
2.1 Të drejtat e mjedisit dhe të njeriut	12
2.2 Ndërlidhjet ndërmjet mjedisit dhe shëndetit të njeriut.....	12
3.0. Dokumente të ngjashme ndërkombëtare.....	15
4.0. Përmbledhje e rasteve studimore të realizuara në rajon dhe botë	21
5.1 TAKIME DHE DISKUTIME	29
5.2. Green Talks.....	36
5.3.Aksion Pastrimi	45
5.4. Punëtori dhe Vizionime.....	52
5.5.Performanca Publike.....	54
5.6.Intervenime.....	60
5.7. Shkollat e aktivizmit	69
6.0.Storjet e suksesit	76
7.0.Harta e Iniciativave.....	80
Konkluzione dhe rekomandime	85
EC ma ndryshe.....	87



Hyrje

Hyrje - Qëllimi dhe metodologjia e hartimit të udhëzuesit

Qëllimi dhe objektivat e udhëzuesit

Ky udhëzues ka për qëllim përmbledhjen e aktiviteteve kryesore të projektit "Human Rightivism - aktivizmi për të drejtat e njeriut", duke përfshirë këtu hapat dhe mekanizma praktikë për aktivizmin mjedisor të të rinjëve dhe për promovimin, vullnetarizmin dhe përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore. Përgjatë këtij dokumenti janë të përfshira prezentimet, punëtoritë dhe vizionimet e mbajtura nëpër qytete të ndryshme të vendit tonë, takime dhe diskutime me qytetarët, "green talks"-biseda për mjedisin, aksione pastrimi, performanca publike, intervenime, gara mjedisore etj. Për mes evaluimit të pritshmërive nga realizimi i iniciativave në terren, udhëzuesi kategorizon praktikatat e mira dhe ato më pak të mira, duke nxitur lexuesin në përjetimin e storjeve të suksesit. Objektivet e udhëzuesit 'AKTIVIZMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT - Manual për promovimin, vullnetarizmin dhe përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore' është gjetja e modaliteteve për nxitjen e aktivizmit dhe vullnetarizmit në komunitet, me theks te të rinjt në zonat rurale të Kosovës, përmes shpalosjes së rezultateve të arritura gjatë projektit si dhe prezentimit të shembujve e dhe praktikave të mira nga rajoni dhe bota.

Metodologjia

Udhëzuesi është zhvilluar sipas metodës kualitative të hulumtimit, Qualitative Reseach Methodology, e cila konsiston në specifikimin e situatave duke zgjedhur si mjete intervistat, diskutimet, analizat dhe observimet. Arsyeja e zgjedhjes së kësaj metode të hulumtimit është për faktin se metoda kualitative është treguar më e suksesshme në hulumtimet që kanë të bëjnë me çështjet sociale, duke gjeneruar rezultate në fjalë dhe jo në numra, llogarira. Me qëllim të pasqyrimin të arritjeve të projektit "Human Rightivism - aktivizmi për të drejtat e njeriut" përgjatë kohështirjes së implementimit të tij, pjesë e metodologjisë së këtij publikimi është edhe dokumentimi sistematik i aktiviteteve të realizuara gjatë këtij projekti. Në bashkëveprim me stafin e projektit, është bërë sistemimi i të gjitha aktiviteteve të realizuara, duke përfshirë këtu kohështirjen e aktivitetit, përshkrimin tekstual të tij, përshkrimin grafik të tij, lokacionin si dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve. Të dhënat e prezentuara në këtë udhëzues jo domosdoshmërisht paraqesin të gjitha aktivitetet e projektit. Duke patur për synim kategorizimin e praktikave të mira dhe atyre më pak të mira nga rradhët e iniciativave të dalura nga komuniteti (Do's and Don'ts), në kuadër të metodologjisë së aplikuar është pëzgjedhur edhe hulumtimi i dokumenteve me tematika relevante, në veçanti përmbledhja e praktikave të mira në rajon dhe në botë.

Tematikat


Duke rajtur kornizën e qëllimit dhe objektivave të vet projektit, udhëzuesi kategorizohet në këto tematika të cilat edhe përbëjnë strukturën e vet dokumentit:

- o Takime dhe diskutime në komunitet
- o “Green talks”- Biseda për mjedisin
- o Aksione Pastrimi
- o Punëtori dhe vizionime
- o Performanca publike
- o Intervenime
- o Dizajnimi i programit dhe realizimi i ‘Shkollës së Aktivizmit’ - për të drejtat e njeriut nëpër qytete të ndryshme
- o Realizimi i nismave të aktivizmit
- o Gara mjedisore
- o Themelimi i grupeve të komunitetit
- o Mentorimi i nismave të aktivizmit dhe grupeve të reja
- o Realizimi i forumeve të partneritetit me grupeve të komunitetit
- o Prezentimi i praktikave të mira të aktivizmit në komunitet në rajon dhe në botë
- o Prezentimi i storjeve të suksesit Do's and Don'ts

- o Rekomandimet

Pritshmëritë pas publikimit të udhëzuesit

Përmes publikimit të këtij udhëzuesi, audienca e synuar do të informohet lidhur me qëllimin dhe objektivat e projektit “Human Rightivism – aktivizmi për të drejtat e njeriut”, sfidave, arritjeve por edhe dështimeve në iniciativat/aktivitetet e ndërmarra përgjatë kohështrirjes së projektit. Ky udhëzues do të informojë komunitetin e gjerë, me theks të veçantë tek të rinjtë, mbi rëndësinë e aktivizmit mjedisor të të rinjëve, vullnetarizmin dhe kontributit të tyre në transformimet që mund të pësojë mjedisi apo hapësira, përfshirjen e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore dhe mundësitë e rritjes potenciale të aktivizmit në mënyrën e të menduarit tek ne si shoqëri; arritjet përmes intervenimeve konkrete në të mirë të komunitetit etj. Analizat krahasuese me rastet e suksesit në rajon dhe botë kanë për qëllim në stimulimin e të rinjëve për aktivizëm më të theksuar në të ardhmen, për stimulimin e tyre për një performancë më të lartë, vetëanalizë të përparësive dhe mangësive në realizimin e iniciativave të ndërmarra nga ata, nxitje për organizim të komunitetit për ndërmarrjen e reformave dhe zhvillimit socio-kulturor etj.



Rreth
projektit

1.0. Përshkrim i projektit dhe objektivave të tij; grupeve të targetuara dhe synimit të përgjithshëm

Projekti "Aktivizmi për të drejtat e njeriut" ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit përmes tri komponenteve:

- 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor;
- 2) Dokumentimi, monitorimi dhe qasja strategjike, dhe
- 3) Të drejtat mjedisore.

Në kuadër të projektit janë realizuar: takime me grupe të ndryshme të komuniteteve dhe përfaqësues të institucioneve, intervenime direkte në hapësira publike për të rritur sasinë e sipërfaqes gjelbëruese, për të krijuar qasje më të lehtë për personat me nevoja të veçanta, trajnime me nxënës dhe studentë, zhvillim të raporteve, hulumtimeve, prodhim të video reportazheve, animacioneve, organizim të debateve/konferencave, performanca publike etj. Projekti realizohet në Prizren dhe Gjakovë por me angazhimin dhe vullnetin e stafit shumë aktivitete janë realizuar edhe në qytete tjera (Dragash, Suharekë, Mamushë, Malishevë, Rahovec, Deçan, Pejë, Ferizaj, Gjiilan, Kamenicë, Kaçanik, Viti, Lipjan, Mitrovicë, Graçanicë, Han të Elezit, Fushë Kosovë, Junik dhe Klinë).

Të rinjtë janë grupi kryesor i synuar i këtij projekti në avancimin e agjendës për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. EC beson në domosdoshmërinë e sigurimit të të rinjve me praktika dhe njohuri krijuese si parakusht për aktivizmin mjedisor të tyre. EC bazohet në konceptin "Edukimi mjedisor" i cili është i ri për shkollat dhe stafin mësimdhënës të Kosovës, dhe përmes saj synohet ndërgjegjësimi dhe aktivizmi mjedisor. Edukimi dhe aktivizmi mjedisor i të rinjve nuk është një ndërhyrje krejtësisht e re për EC-in, pasiçë vazhdimisht puna me ta ka qenë gjithmonë pjesë e projekteve që EC është angazhuar. Puna me të rinjtë kontribuon drejtpërdrejt në adresimin e një shqetësimi madhor të të drejtave të njeriut në vend edhe pse ata përbëjnë grupin më të madh të shumicës së shoqërisë, vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar. Gjithashtu, ndërsa mjedisi është e ardhmja e tyre, ata janë minimalisht të informuar për gjendjen dhe pasojat përmes kurrikulës formale të shkollës. Andaj, EC Ma Ndryshe ka dizenuar këtë veprim i cili bazohet në konceptin e "eko shkollës", një model dhe metodologji, e cila inkurajon të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke ua lejuar atyre këtë mundësi për ta mbrojtur atë në mënyrë aktive. Ky sistem fillon në klasë; zgjerohet në shkollë dhe përfundimisht nxit ndryshimin në komunitet në përgjithësi.

1.1. Statistikat nga aktivitetet

Publikime (udhërrëfytes, raporte monitorimi dhe hulumtime) – 36 publikime.

Infografika – 161 infografika.

Video sensibilizuese – 20 video sensibilizuese.

Artikuj dhe opinione – 22 artikuj/opinione.

Punëtori dhe raporte vizionimi – 4 punëtori vizionimi dhe 3 raporte të vizionimit

Shkolla të Aktivizmit në Komunitet – 3 shkolla me 90 të rinjë e të reja nga komuna e Prizrenit, Rahovecit, Malishevës, Suharekës, Dragashit, Deçanit, Gjakovës, Pejës, Ferizajt, Gjilanit, Hanit të Elezit, Kamenicës dhe Kaçanikut.

Debate të Gjelbra – 14 debate me rreth 280 të rinj prezent nga komuna e Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Ferizajt, Mitrovicës së Jugut, Lipjanit, Rahovecit, Dragashit, Fushë Kosovës, Graçanicës, Junikut, Klinës dhe Suharekës.

Intervenime direkte (intervenime në mobiluar urban, mbjellje dhe intervenime të ndryshe artistika në hapësira publike dhe shkolla) – 28 intervenime direkte.

Aksione Pastrimi – rreth 8 aksione të pastrimit në hapësira publike me vullnetarë.

Performanca publike – rreth 11 performanca publike

Konferenca – 3 konferenca vjetore.

Kuize online – 1 kuiz me 10 seri.

Takime me grupe të ndryshme të komunitetit – mbi 30 takime me grupe të ndryshme të komunitetit.

Gara mjedisore me të rinj – 3 gara mjedisore, 91 aplikime nga 458 nxënës.



Të drejtat e njeriut dhe aktivizmi

2.0 Të drejtat e njeriut dhe aktivizmi

Një strategji për ndërlidhjen mes të drejtave të njeriut dhe degradimit të mjedisit është të theksohen objektivat thelbësore të përbashkëta nga të dyja anët dhe shkaqet e përbashkëta pa vendosur të drejta të reja apo të drejta mjedisore. Edhe në qoftë se mjedisi nuk është as subjekt dhe as objekt i të drejtave, disa lloje të dëmeve mjedisore mund të cenojnë në mënyrë indirekte të drejtat e njeriut, si për shembull, kur ndotja kërcënon shëndetin e njerëzve, ndërkohë që degradon edhe mjedisin fizik në të cilin ata banojnë.¹ Ndërkaq, kryqëzimi i çështjeve mjedisore dhe të drejtave të njeriut është një temë mjaft kritike dhe komplekse. Si mbrojtja e mjedisit ashtu edhe ruajtja e të drejtave të njeriut janë thelbësore për mirëqenien e individëve dhe komuniteteve. Disa prej pikave kryesore të cilat theksojnë lidhjen midis çështjeve mjedisore dhe të drejtave të njeriut përfshijnë:

- Të drejtën për një mjedis të shëndetshëm që konsiderohet si një e drejtë themelore e njeriut, ku një mjedis i pastër dhe i sigurt është thelbësor për mirëqenien e përgjithshme të individëve dhe komuniteteve ;
- Qasjen në ujë të pastër dhe kanalizime ku e drejta e ujit njihet si një e drejtë themelore e njeriut, duke përfshirë këtu edhe raste ku shumë njerëz në mbarë

botën nuk kanë qasje në ujë të pijshëm të pastër, gjë e cila mund të çojë në një sërë çështjesh për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtën e jetës dhe shëndetit.

- Të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje, që është thelbësore në vendimmarrjen e mjedisit, përfshirë komunitetet të cilët kanë të drejtë të informohen për çështjet e mjedisit dhe të marrin pjesë në vendime që mund të ndikojnë në mjedisin dhe mirëqenien e tyre.
- Mbështetja e aktivistëve dhe mbrojtësëve të mjedisit, fokus i veçantë duhet të ju kushtohet edhe kësaj kategorie të cilët shpesh dijnë të përballen me kërcënime dhe jo-respekt ndërsa punojnë për të mbrojtur mjedisin dhe avokuar për të drejtat e njeriut. Kjo çështje nënvizon nevojën për të mbrojtur të drejtat e atyre që janë duke punuar për të mbrojtur mjedisin gjithëpërfshirës.

Adresimi i kryqëzimit të çështjeve mjedisore dhe të të drejtave të njeriut kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë bashkëpunim midis qeverive, bizneseve, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Kjo qasje duhet të synojë të mbrojtë si mjedisin ashtu edhe të drejtat themelore dhe mirëqenien e individëve dhe komuniteteve.

¹ Environmental Rights - Edited by Steve Vanderheiden

<https://www.taylorfrancis.com/books/edit/10.4324/9781315094427/environmental-rights-steve-vanderheiden?refId=231d554c-6078-4fcf-a71a-e9940076ed0c&context=ubx>

2.1 Të drejtat e mjedisit dhe të njeriut


Në rast se i analizojmë të drejtat njerëzore dhe mjedisore së bashku ato përfaqësojnë marrëdhëniet e ndërlidhura dhe të ndërvarura midis mirëqenies së njerëzve dhe shëndetit të planetit. Njohja dhe ruajtja e këtyre të drejtave është thelbësore për krijimin e shoqërive të qëndrueshme, të drejta dhe të barabarta. Me rëndësi të veçantë është edhe koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm i cili integron konsideratat mjedisore, sociale dhe ekonomike. Balancimi i këtyre elementeve është thelbësor për përmbushjen e nevojave të së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre, duke respektuar kështu kapitalin ndërgjenerues. Si përfundim, lidhja midis të drejtave njerëzore dhe mjedisore është thelbësore në qëllimin e përbashkët të krijimit të një bote ku dy kategoritë së bashku, njerëzit dhe planeti mund të lulëzojnë. Duke njohur dhe promovuar këto të drejta të ndërlidhura, shoqëritë mund të punojnë drejt arritjes së një ekuilibri harmonik që siguron mirëqenien e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm. Kjo qasje thekson nevojën për praktika të qëndrueshme, administrimin e mjedisit dhe mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave njerëzore.

2.2 Ndërlidhjet ndërmjet mjedisit dhe shëndetit të njeriut

Përmes ilustrimit në vijim është theksuar se ekzistojnë gjithashtu ndërlidhje midis politikave mjedisore dhe atyre të cilat lidhen me shëndetin, dhe se sjelljet pro-mjedisore mund të ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut dhe gjithashtu të përmirësojnë kushtet mjedisore, duke përfituar kështu në mënyrë indirekte shëndetin. Për shembull, politikat të cilat mbështesin rritjen e udhëtimeve në formë active, veçanërisht ecjen ose çiklizmin kanë potencial për përfitime të shumëfishta për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, duke përfshirë reduktimin e emetimeve të karbonit, përmirësimin e cilësisë së ajrit urban, duke pasur kështu ndikim pozitiv edhe në aspektin shëndetësor dhe promovimin e jetës së përditshme. Në të kundërt, politikat promovuese të shëndetit mund të kenë ndikime të dëmshme në mjedis, me ndikime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta edhe në shëndetin e njeriut. Si për shembull, rritja e recetave të lidhura me plakjen e popullsisë dhe përmirësimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor mund të çojë në lëshimin e produkteve farmaceutike dhe metabolitëve të tyre. (Depledge 2011).²

² Bringing health and the environment into decision making: A natural capital framework – ResearchGate https://www.researchgate.net/publication/326994773_Bringing_he

[alth_and_the_environment_into_decision_making_A_natural_capita
L_framework](#)



← NDIKIMET NEGATIVE

→ NDIKIMET POZITIVE

**Dokumente të
ngjashme
ndërkombëtare**

3.0. Dokumente të ngjashme ndërkombëtare

3.1. Local Environmental Initiatives Oriented to Children and Youth: A Review of UN-Habitat Best Practices. Children, Youth and Environments

Ky punim paraqet rezultatet e një studimi të objektivave dhe metodave të një përzgjedhjeje të nismave mjedisore të orientuara nga fëmijët dhe të rinjtë në mbarë botën. Qëllimi i tij është të rishikojë se si komunitetet lokale dhe komunat po punojnë për të krijuar mjedise fizike që mbështesin të drejtat dhe prioritetet e fëmijëve. Për këtë qëllim, ne përdorim një kornizë të qytetit miqësor për fëmijët në një ekzaminim të 101 praktikave "të mira", "më të mira" dhe "fituese me çmime" të identifikuara nga UN-Habitat. Ne i plotësojmë këto të dhëna me përgjigjet ndaj një pyetësi të vetë-administruar, dërguar një nëngrupi të rasteve në bazën e të dhënave të OKB-së. Ne ofrojmë profile të disa praktikave të cilat premtojnë të ofrojnë njohuri të vlefshme për dinamikën e praktikave të bazuara në komunitet që janë të orientuara ndaj nevojave të fëmijëve dhe që sugjerojnë udhëzime për kërkime për të udhëhequr më tej praktika të tilla.³

3.2. Children and youth environmental action: The case of children and youth with disabilities.

Aktivizmi mjedisor rinor është në rritje. Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara ndikohen në mënyrë disproporcionale nga problemet mjedisore dhe aktivizmi mjedisor. Ata gjithashtu përballen me barriera për pjesëmarrjen në aktivizëm, shumë prej të cilave mund të vlejné edhe për pjesëmarrjen e tyre në aktivizmin mjedisor. Duke përdorur një qasje të rishikimit të fushëveprimit, ne hetuam angazhimin me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara nëpërmjet (a) literaturës akademike që mbulon aktivizmin mjedisor të të rinjve dhe grupeve të tyre dhe (b) tweet-eve të grupit të aktivizmit mjedisor të të rinjve (Fredays For Future). Shkarkuam 5536 abstrakte nga 70 bazat e të dhënave të EBSCO-HOST dhe Scopus dhe 340 cicërime të të premtëve për të ardhmen dhe analizuam të dhënat duke përdorur analizën e përmbajtjes së drejtuar cilësore. Nga 5536 abstrakte, asnjëri nuk trajtoi fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara si aktivistë mjedisorë, ndikimin e aktivizmit mjedisor ose problemet mjedisore si ndryshimi i klimës tek fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Katërmbëdhjetë treguan se faktorët mjedisorë 'shkaktuan' 'dëmtimet' tek fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Njëri sugjeroi se natyra mund të jetë e dobishme për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi

³ Darcy Varney, & Willem van Vliet. (2005). Local Environmental Initiatives Oriented to Children and Youth: A Review of UN-Habitat Best Practices. *Children, Youth and Environments*, 15(2), 41-52. <http://www.jstor.org/stable/10.7721/chilyoutenvi.15.2.0041>

të kufizuara. Tweetet nuk përmendnin fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Gjetjet tona sugjerojnë nevojën për më shumë angazhim me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në lidhje me aktivizmin mjedisor të të rinjve dhe sfidat mjedisore.⁴

3.3. Global youth activism on climate change. *Social Work & Policy Studies: Social Justice, Practice and Theory*

Ky rishikim i literaturës eksploron rritjen e fundit eksponenciale të një lëvizjeje rinore globale që është e fokusuar në adresimin e ndryshimeve klimatike. Ai shqyrton disa nga faktorët rastësorë për rritjen dhe përmes një lente kritike shqyrton disa nga përgjigjet moshore dhe paternaliste që nxit lëvizja. Ndjenjat e shpresës dhe lidhjes me grupe, lëvizje dhe organizata të tjera në mbarë botën ishin disa nga ndikimet pozitive të identifikuar. U zbulua se lëvizja ka devijuar fokusin tek shkaqet strukturore dhe sistematike të ndryshimeve klimatike. Rishikimi përfundon duke nënvizuar rolin dhe përgjegjësinë që kanë punonjësit socialë në adresimin e kësaj çështjeje të drejtësisë sociale dhe mënyrat në të cilat ata mund të punojnë në solidaritet dhe të mbështesin aktivistët rinorë. Një rol kyç i identifikuar ishte avokimi, me fokus në avokimin për të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për

pjesëmarrje dhe përfshirje në diskutime dhe vendimmarrje formale në lidhje me këtë çështje.⁵

3.4. Children, adolescents, and youth pioneering a human rights-based approach to climate change. *Health and Human Rights*

Ndryshimet klimatike janë sfida më e madhe e shekullit tonë. Fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë do të kenë ndikimet më të rënda, fizikisht, socialisht, ekonomikisht dhe psikologjikisht. Në përgjigje të këtij kërcënimi të jashtëzakonshëm dhe dështimit të negociatave ndërkombëtare për klimën deri më sot, të rinjtë po dalin në rrugë dhe po përdorin forumet globale për të kërkuar drejtësi për klimën. Ndërsa këto protesta kanë marrë shumë vëmendje, ka pasur një shqyrtim të kufizuar të këtyre dhe përpjekjeve të tjera të udhëhequra nga të rinjtë përmes thjerrëzës së një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe parimeve të saj operacionale: pjesëmarrja, barazia dhe mosdiskriminimi, llogaridhënia dhe transparenca. Ky punim bazohet në literaturën akademike dhe gri, si dhe nga përvoja e autorëve si praktikues dhe aktivistë të rinj, për të argumentuar se të rinjtë, duke promovuar parimet operacionale të bazuara në të drejtat e njeriut në nivel

⁴ Salvatore, C. and Wolbring, G., 2021. Children and youth environmental action: The case of children and youth with disabilities. *Sustainability*, 13(17), p.9950. <https://www.mdpi.com/2071-1050/13/17/9950>

⁵ Cloughton, I., 2021. Global youth activism on climate change. *Social Work & Policy Studies: Social Justice, Practice and Theory*, 4(1). <https://openjournals.library.sydney.edu.au/SWPS/article/view/14960>

ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal, janë pionierë për një njeri. qasje e bazuar në të drejtat ndaj ndryshimeve klimatike. Dokumenti përfundon duke sugjeruar se si politikëbërësit mund të mbështesin dhe fuqizojnë të rinjtë për të çuar përpara një agjendë të qartë të bazuar në të drejtat e njeriut, duke përkthyer njëkohësisht parimet operationale të bazuara në të drejtat e njeriut në politikat dhe praktikat e ndryshimeve klimatike.⁶

3.5. Integrating youth perspectives: adopting a human rights and public health approach to climate action. *International Journal of Environmental Research and Public Health*

Ndryshimet klimatike janë një çështje shumëdimensionale që prek të gjitha aspektet e shoqërisë, duke përfshirë shëndetin publik dhe të drejtat e njeriut. Ndryshimi i klimës tashmë po ndikon rëndë shëndetin e njerëzve dhe po kërcënon të drejtat themelore të garantuara të njerëzve, duke përfshirë ato për jetën, shëndetin, vetëvendosjen dhe arsimin, ndër të tjera. Në të gjithë rajonet gjeografike, grupet e popullsisë dhe komunitetet që janë tashmë të marginalizuara për shkak të moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, të ardhurave dhe faktorëve të tjerë socio-ekonomikë, janë ata që janë prekur në mënyrë disproporcionale nga ndikimet klimatike, pavarësisht se kanë kontribuar më së paku në emetimet globale. Megjithëse studiuësit kanë bërë thirrje për një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe një perspektivë shëndetësore ndaj veprimit klimatik, literatura që shikon këtë kryqëzim multidisiplinor është ende në lindje dhe qeveritë duhet të zbatojnë ende politika të tilla ndërsektorale. Ky koment fillon të reflektojë mbi marrëdhënien midis ndryshimit të klimës, të drejtave të njeriut dhe shëndetit publik nga këndvështrimi i të rinjve të angazhuar në veprimin dhe

⁶ Gasparri, G., El Omrani, O., Hinton, R., Imbago, D., Lakhani, H., Mohan, A., Yeung, W. and Bustreo, F., 2021. Children, adolescents, and youth pioneering a human rights-based approach to climate change. *Health and Human Rights*, 23(2), p.95.

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC8694303/>

diskursin klimatik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ai paraqet një rrugë përpara për atë që ne, si avokatë dhe studiues të rinj të klimës, besojmë se është një prioritet për të realizuar integrimin ndërsektorial të qasjeve të të drejtave të njeriut dhe shëndetit publik ndaj ndryshimeve klimatike. Së pari, studiuesit dhe praktikuesit duhet të shqyrtojnë dhe mbështesin ndërhyrjet klimatike të udhëhequra nga të rinjtë që trajtojnë të drejtat e njeriut dhe shkeljet e shëndetit publik të shkaktuara nga kriza klimatike. Së dyti, qasjet pjesëmarrëse ndaj ndryshimeve klimatike duhet të dizajnohen duke punuar në mënyrë sinergjike me grupet e cënueshme nga klima, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, praktikuesit dhe studiuesit në sektorët e shëndetit publik dhe të të drejtave të njeriut për të trajtuar në mënyrë holistike ndikimet sociale, shëndetësore dhe mjedisore të krizës klimatike dhe shkaqet kryesore të padrejtësisë. Së fundi, ne rekomandojmë mbledhjen më holistike të të dhënave për të informuar më mirë politikat klimatike të bazuara në prova që funksionalizojnë të drejtat e njeriut dhe përfitimet e përbashkëta të shëndetit publik.⁷

3.6. Globalisation of youth activism and human rights. Global Youth Action Network and Peace Child International

Për dekada të tëra të rinjtë kanë qenë në ballë të lëvizjeve shoqërore dhe ndryshimeve shoqërore, duke e bërë aktivizmin asgjë tjetër veçse një modë. Përkundrazi, është një mjet për ata që mendojnë se ka ndodhur një padrejtësi dhe vendosin të veprojnë kundër saj. Edhe pse vetëm një pjesë e të rinjve i përkasin kategorisë 'aktivistë', ata që e bëjnë këtë mbartin një energji që ka rezultuar e rëndësishme në arritjen e ndryshimeve shoqërore. Aktivistët kanë mësuar të përdorin mjetet dhe proceset e globalizimit për të nxitur ndryshime shoqërore. Në mesin e shumë aktivistëve ekziston besimi se në asnjë moment të historisë mundësia për ndryshim nuk ka qenë aq e nevojshme dhe e nevojshme. Të rinjtë bëhen aktivistë për shumë arsye, por shpesh si përgjigje ndaj abuzimit të të drejtave të njeriut, degradimit të mjedisit ose thjesht si një mënyrë për të shprehur zemërimin e tyre ndaj padrejtësive politike, sociale, ekonomike ose mjedisore që kanë dëshmuar. Për shumë të rinj, globalizimi ka nënkuptuar një ndërgjegjësim më të madh për këto abuzime përmes lidhjeve globale dhe fushatave të mirëpublikuara. Aty ku dikur çështjet e vetme ishin fokusi i shumë aktivistëve, globalizimi ka nxjerrë në pah një kuptim të

⁷ Gasparri, G., Tcholakov, Y., Gepp, S., Guerreschi, A., Ayowole, D., Okwudili, É.D., Uwandu, E., Sanchez Iturregui, R., Amer, S., Beaudoin, S. and Sato, M., 2022. Integrating youth perspectives: adopting a human rights and public health approach to climate action.

International Journal of Environmental Research and Public Health, 19(8), p.4840.
<https://www.mdpi.com/1660-4601/19/8/4840>

shumëanshëm dhe të ndërlidhur të proceseve globale. Për shembull, çështje të tilla si ngrohja globale tani kuptohen si sfida ekonomike po aq sa edhe mjedisore.⁸

3.7. Advocating for environmental changes to increase access to parks: engaging promotoras and youth leaders. Health promotion practice

Qasja në mundësitë e aktivitetit fizik janë të kufizuara në komunitetet e pashërbyera. Programet e bazuara në komunitet mund të rrisin promovuesit dhe kapacitetin e udhëheqësve të rinj për të avokuar për ndryshimet e ndërtuara mjedisore. Promovuesit dhe drejtuesit e të rinjve u trajnuan për vlerësimin e ecjes, auditimin e parkut dhe avokimin. Të rinjtë dhe promovuesit nga një kishë e vendosur ngjitur me një park zbatuan një anketë në komunitet, kryen auditime në ecje dhe u angazhuan në aktivitete ndërgjegjësuese rreth faktorëve mjedisorë që prekin komunitetet. Ata gjithashtu mobilizuan anëtarët e komunitetit për të mbrojtur një park aty pranë. Taktikat e avokimit përfshinin pjesëmarrjen dhe bërjen e prezantimeve në Këshillin Bashkiak, planifikimin e takimeve, organizimin e panairëve shëndetësore dhe bisedën me anëtarët e komunitetit. Ndryshimet e

mëposhtme u bënë në park: hiqen bimët e mbipopulluara, zhvendosja e kontejnerit të magazinimit, rritja e sigurisë së parkut (d.m.th., ndriçimi, rrethimi), siguria e përmirësuar (d.m.th., kanalizimi i mbuluar i kanalizimeve, hiqet pjesa e rërës), përmirësimi i komoditeteve (d.m.th., shatërvani për pije, banjo, stola, tavolina), siguria e përmirësuar e këmbësorëve në park (d.m.th., rrafshoi shtigjet e vjetra dhe shtoi shtigjet e reja të ecjes), dhe përmirësimi i zonës së lojës për fëmijë (d.m.th., pajisje të reja për lojëra, gardhe). Programi aktual thekson faktorët që kontribuan në ndryshimet e parkut dhe sfidat në rritjen e aksesit në parqe. Për më tepër, studimi aktual vë në dukje hapat që programet e tjera mund të ndërmarrin për të bërë ndryshime mjedisore.⁹

⁸ Koffel, C., 2003. Globalisation of youth activism and human rights. Global Youth Action Network and Peace Child International, pp.117-127. <https://kaleidoscope2007.pbworks.com/f/YGACTIVISMHUMANRIGHTS.pdf>

⁹ Arredondo, E., Mueller, K., Mejia, E., Rovira-Oswalder, T., Richardson, D. and Hoos, T., 2013. Advocating for environmental changes to increase access to parks: engaging promotoras and youth leaders. Health promotion practice, 14(5), pp.759-766. <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/1524839912473303>

3.8. Human rights education: Ideology, location, and approaches. *Human Rights Quarterly*

Ndërsa edukimi për të drejtat e njeriut (EDNJ) bëhet një tipar më i zakonshëm i diskutimeve të politikave ndërkombëtare, reformës kombëtare të teksteve shkollore dhe strategjive arsimore pas konfliktit, nevojitet një qartësi më e madhe rreth asaj se çfarë është, çfarë bën dhe çfarë mjetesh EDNJ. Ky artikull shqyrton përkufizimet dhe modelet ekzistuese të EDNJ-së dhe argumenton se ideologjia – po aq sa vendndodhja ose variablat e tjerë – ofron një mjet për të skematizuar qasje të ndryshme ndaj EDNJ. Ky artikull shqyrton modelet e organizuara rreth parimeve të qytetarisë globale, bashkëjetesës dhe veprimet transformues në kontekstin e një shteti-komb (India) dhe sugjeron se ndryshueshmëria dhe përshtatshmëria e edukimit për të drejtat e njeriut janë rruga e tij.¹⁰

3.9. Perspectives of research on human rights education. *Journal of human rights education*

Ky artikull përmbledh disa nga kërkimet e disponueshme mbi edukimin për të drejtat e njeriut (EDNJ) duke u ndarë në tre kategori kryesore: teoria e EDNJ, zbatimi i EDNJ dhe rezultatet e EDNJ. Artikulli ilustron se ekziston një bazë literaturë në rritje për EDNJ, bazuar në tradita të tilla si pedagogjia kritike, studimet krahasuese të arsimit, teoria e politikës botërore, analiza e teksteve shkollore dhe kurrikulare, ndryshimi i shkollës, studimet në klasë, mësimi i të rriturve, mësimi transformues dhe zhvillimi i të rinjve. Pas prezantimit të rezultateve kryesore, autorët propozojnë që kërkimet e ardhshme mund të vazhdojnë në të njëjtën mënyrë, ndërsa në të njëjtën kohë të përqendrohen më plotësisht në vlerësimet e lidhura me ndikimin.¹¹

¹⁰ Bajaj, M., 2011. Human rights education: Ideology, location, and approaches. *Human Rights Quarterly*, pp.481-508. <https://www.jstor.org/stable/23016023>

¹¹ Tibbitts, F. and Kirchschräger, P.G., 2010. Perspectives of research on human rights education. *Journal of human rights education*, 2(1), pp.8-29.

https://www.researchgate.net/profile/Felisa-Tibbitts/publication/290605330_PERSPECTIVES_OF_RESEARCH_ON_HUMAN_RIGHTS_EDUCATION/links/569a6ed808aeaea9859d0378/PERSPECTIVES-OF-RESEARCH-ON-HUMAN-RIGHTS-EDUCATION.pdf

4.0. Përmbledhje e rasteve studimore të realizuara në rajon dhe botë

Aktivizmi mjedisor i udhëhequr nga të rinjtë:

4.1. Rast Studimi: Të Premtet për të Ardhmen

Të Premtet për të Ardhmen, të iniciuara nga Greta Thunberg, fituan vëmendjen globale si një lëvizje e udhëhequr nga të rinjtë që kërkon veprim urgjent për ndryshimin e klimës. Më 8 shtator, Greta dhe kolegët e saj grevistë të shkollës vendosën të vazhdojnë grevën e tyre derisa politikat suedeze të ofrojnë një rrugë të sigurt nën 2°C, pra në përputhje me marrëveshjen e Parisit. Ata krijuan hashtagun #FridaysForFuture dhe inkurajuan të rinj të tjerë në mbarë botën që t'u bashkohen atyre. Kjo shënoi fillimin e grevës globale të shkollave për klimën. Thirrja e tyre për veprim ndezi një zgjim ndërkombëtar, me studentë dhe aktivistë të bashkuar anembanë globit për të protestuar jashtë parlamenteve dhe bashkive të tyre lokale. Së bashku me grupe të tjera anembanë botës, të Premtet për të Ardhmen është pjesë e një vale të re shpresëdhënëse ndryshimi, duke frymëzuar miliona njerëz që të ndërmarrin veprime për krizën klimatike.¹²



Fig.1 & 2.Pamje nga aktiviteti Fridays for Future

¹² <https://fridaysforfuture.org/>

4.2. Youth Climate Lab

Fokusi: Veprimi për Klimën, Inovacioni dhe Avokimi i Politikave

Rast Studimi: "Youth Climate Lab" punon globalisht për të fuqizuar të rinjtë që të ndërmarrin veprime për ndryshimin e klimës. Ata angazhohen në projekte që përfshijnë zhvillimin e zgjidhjeve klimatike, ndikimin e politikave dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme. Iniciativat e tyre shpesh përfshijnë elemente të dizajnit urban dhe zgjidhje funksionale për të adresuar sfidat mjedisore. Çka ofron kjo organizatë në lidhje me mjetet në promovimin e praktikave të qëndrueshme është kutia e veglave Youth Climate Lab (YCL) është një bibliotekë dixhitale me akses të hapur me burime interaktive për të ndihmuar shfrytëzimin dhe përvojat e tyre si ekspertizë dhe të ndërmarrin veprime për çështjet kryesore të klimës. Këto mjete dhe aktivitete u krijuan për të qartësuar proceset e politikave klimatike, për të rritur njohuritë për kryqëzimet e drejtësisë klimatike dhe për të ndërtuar aftësi të tilla si mendimi kritik, dizajni, avokimi dhe komunikimi efektiv. Një nga shumë aktivitete të kësaj organizate në lidhje me veprimet mbi zgjidhjen klimatike është projekti "Moving the Needle Cohor" apo Lëvizja e grupit të gjilpërave ku ky grup i bazuar në art mblodhi krijuesit e rinj për të eksploruar pyetjet, "Ku jemi tani?" "Ku duam të

shkojmë?" dhe "Si të arrijmë atje?" në lidhje me veprimin klimatik dhe një ekonomi me karbon të ulët.¹³

#MoveTheNeedle ishte mbishkrimi mbi bisedat klimatike ku prioritet ishte angazhimi i perspektivave unike të artistëve në mënyrë që të krijohet hapësirë për artistët brenda lëvizjes klimatike. Nëpërmjet narrativave të tyre, është marrë parasysh shkallët e ndryshme që mund të ndërmarrin veprime klimatike drejt një ekonomie me karbon të ulët. Disa nga projektet e aktivistëve:



Fig.3. Disa nga punimet e aktivistëve



¹³ <https://youthclimatetoolbox.com/hub/moving-the-needle>

4.3. Greening Forward

Fokusi: Edukimi mjedisor, Fuqizimi i të rinjve

Rast Studimi: Greening Forward është një organizatë e udhëhequr nga të rinjtë që fokusohet në edukimin dhe fuqizimin mjedisor. Ata mbështesin projekte dhe iniciativa që promovojnë jetë të qëndrueshme, drejtësi mjedisore dhe zgjidhje funksionale të projektimit për një të ardhme më të gjelbër.

Këto raste studimore ilustrojnë se si organizatat joqeveritare të udhëhequra nga të rinjtë po kontribuojnë në mënyrë aktive në çështjet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut përmes projekteve inovative, ndërhyrjeve të projektimit urban dhe zgjidhjeve funksionale të projektimit. Nëpërmjet granteve, mentorimeve, konferencave dhe programeve të tjera, Greening Forward ofron mbështetje për të rinjtë për të krijuar ndryshime reale për çështjet për të cilat ata janë të pasionuar. Marrin energjinë dhe mendësinë rinore dhe i kombinojnë ato me mjetet dhe strukturën. Disa nga projektet kryesore të kësaj organizate janë:

Programi i Edukimit Mjedisor

Programi i Edukimit Mjedisor nëpërmjet seminareve interaktive, burimeve angazhuese dhe përvojave praktike të të mësuarit, nxisin një kuptim dhe vlerësim më të thellë për botën natyrore.



Fig.4. Klubi i kurseve të Tokës

Greening Forward Cameroon

Për shkak se Kameruni është një vend që përballet me disa nga ndikimet më të këqija mjedisore, kjo organizatë ka bërë një mision të siguroj që projekti në Kamerun të edukojë, angazhojë dhe fuqizojë të rinjtë në komunitetet e tyre për të ndërmarrë veprime për çështjet që prekin komunitetet. Studentët tanë në Kamerun kanë punuar në projekte si konkurse komike mjedisore, seminare për edukimin e oqeanit, pastrimin e plazheve dhe shumë më tepër.¹⁴

Fig.5. Aktivistet e "Greening Forward Cameroon"



¹⁴

<https://www.greeningforward.org/programs/greening-forward-cameroon>

Clean Ups and Outreach on Plastic

Në bazë të përkushtimit për të adresuar çështjen globale të ndotjes plastike. Kjo organizatë organizon në mënyrë aktive fushata pastrimi për të hequr mbetjet plastike nga mjedisi dhe bashkëpunojnë me organizatat lokale, shkollat dhe qendrat komunitare për aktivitete informuese. Nëpërmjet fushatave të pastrimit, vullnetarët mblidhen së bashku për të përmirësuar pamjen vizuale të mjedisit dhe për të parandaluar që mbetjet plastike të ndotin ekosistemet.¹⁵

Fig.6. Aktivistet e "Clean Ups and Outreach on Plastic"



¹⁵ <https://www.greeningforward.org/programs/beat-plastic-program/clean-ups-and-outreach-on-plastic>

4.4. "SPUR - IDEAS + ACTION FOR A BETTER CITY"

Është organizatë me bazë në komunitet e cila vepron në San Francisco, San Jose and Oakland. Qëllimi i saj është suportimi i grupeve joformale me qëllim të ndikimit në proceset e planifikimit urban dhe përmirësimit të jetës në komunitet në mënyrë të pavarur, pa pasur ndikim nga politikat qeverisëse. Kjo organizatë ofron përfshirjen në baza të rregullta të të rinjve, të cilët në mënyrë vullnetare iniciojnë dhe udhëheqin projekte të ndryshme të cilat kanë për rezultat ndërmarrjen e intervenimeve direkte në hapësira të ndryshme të komunitetit. Përpos prodhimit të dokumenteve hulumtuese dhe projekteve konkrete, rëndësishme është përfshirja e të rinjve, nxënësve dhe studentëve, në propozime të cilat japin një vizion tjetër për qytetet në të cilat kjo organizatë vepron. Këtu vë në theks promovimin e vizionit për qytete pa automjete, më shumë çiklizëm, më shumë hapësira gjelbëruese, liri e lëvizjes në trotuare etj.



4.5. "ProstoRož"



Është komunitet kulturor me bazë në Slloveni që ka për synim përmirësimin e jetës në hapësirat publike dhe gjithçka që lidhet me publikun. Ky komunitet 'përdor' të rinjt dhe fëmijët për të ekspoluar? mbi nevojat e komunitetit, pr ak tik isht banor ëv e të lok alitetev e të caktuara me qëllim të adresimit të tyre në politika lokale dhe qëndrore dhe përmirësimin të tyre. Ky komunitet shqyrton me kujdes pr oblemet e adr esuar a nga komuniteti , dhe angazhohet në përmirësimin e nevojave të tyre duk e ndërmarrë aksione direkte. Rëndësia e këtij komuniteti është në eduk imin e gjeneratave të reja për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në përmirësimin e jetës në komunitet. Sipas kësaj organizate, inter venimet minimale në hapësirat publike janë aksione të mjaftueshme për të bindur të rinjt që aktivizmi i tyre ndikon në adresimin dhe përmirësimin e jetës në komunitet. Aksionet e tyre, të cilat janë ngusht të lidhura edhe me drejtoritë komunale, organizatat e tjera kulturore si dhe institucionet relevante, kanë për fokus

qytetarin, me theks të rinjt dhe fëmijët, dhe kërkesat e adresuara nga ta.

Prostoroz"



Përmbledhja e aktiviteteve

Takime dhe Diskutime





5.1 TAKIME DHE DISKUTIME

EC si organizatë me bazë në komunitet angazhohet për qëndrueshmëri përmes mobilizimit të komunitetit, andaj edhe për vite me rradhë organizon takime dhe diskutime të rregullta me qytetarë dhe grupe të ndryshme të komunitetit.

Takimet direkte dhe diskutimet me qytetarët janë një mjet efektiv për të adresuar dhe zgjidhur problemet e ndryshme në një komunitet. Ky ndërveprim ndihmon në kuptimin e nevojave të qytetarëve, nxit pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse dhe krijon mundësi për bashkëpunim të ngushtë midis autoriteteve lokale dhe komunitetit.

Përmes këtyre takimeve kuptojmë nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve duke ju dhënë mundësinë t'i dëgjojmë drejtëpërdrejtë për të kuptuar më mirë sfidat me të cilat ballafaqohen dhe të identifikuar prioritetet e tyre.

Përmes takimeve direkte ne nxisim pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Duke i bërë ata pjesë të diskutimeve dhe vendimmarrjeve,

krijohet një ndjenjë e përgjegjësisë dhe transparencës. Pjesëmarrja e qytetarëve në takime direkte rrit vetëdijenë dhe kapacitetin e tyre për të mbrojtur interesat e tyre. Kjo mund të çojë në një bashkëpunim më të mirë midis komunitetit dhe autoriteteve lokale.

Andaj duke i identifikuar dhe diskutuar problemet lokale në takime direkte, ne mundohemi të arrijmë zgjidhje konkrete dhe të përshtatshme për situata të ndryshme të komunitetit.

Në kuadër të këtij projekti ka organizuar dhe mbajtur takime me grupe të ndryshme të komunitetit, me të rinjë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, organizata dhe shoqata të ndryshme, institucione arsimore, autoritete lokale dhe qendrore, ku janë diskutuar shumë çështje në lidhje me të drejtat e njeriut dhe problemet mjedisore në vend. Takime të tilla kanë shërbyer si mjet për të bashkëpunuar në adresim të shumë çështjeve që ata i preokupojnë.

Aktivizmi për të drejtat e njeriut



Fig.10. Pamje nga takimi me nxënësit e shkollës së mesme të lartë teknike "11 Marsi" në Prizren

Fig.11. Gjatë takimit virtual diskutimet me nxënësit dhe menaxhmentin e shkollave




Fig.12 Pamje gjatë aktivitetit




Fig.13. Pamje gjatë takimeve virtuale me nxënësit e shkollave fillore dhe e mesme e ulët në Lipjan.



Fig.14. Pamje gjatë takimit me zyrtarët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Në Prizren

Fig.15 Pamje nga takimet me OJQ, Institucione, Banorë



Fig.16 Takimi dhe aktivitetet me të rinjtë e Suharekës






Fig.17. Kuvendi i të Rinjëve në Prizren



Green Talks



5.2. Green Talks

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është nxitja e debatit për çështjet mjedisore mes nxënësve të shkollave dhe përfaqësuesve të institucioneve, duke i dhënë hapësirë të dyja palëve të njoftohen lidhur me idetë dhe angazhimet e njëri-tjetrit në këtë fushë.

Nxënësit e të gjitha shkollave kanë pasur mundësinë që të shpalosin punët dhe aktivitetet mjedisore që ata realizojnë në shkollat e tyre para kryetarit të komunës së tyre. E në të njejtën kohë edhe përfaqësuesit e komunës patën mundësinë që para nxënësve të shpalosin për angazhimet dhe planet e tyre, me fokus në çështjet mjedisore.

Gjatë periudhës implementuese të projektit janë realizuar gjithsejtë 14 debate të gjelbra në 14 komuna në të gjitha rajonet e Kosovës (Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Suharekë, Dragash, Rahovec, Lipjan, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Klinë, Graçanicë dhe Junik).

Në të gjitha këto debate janë angazhuar mbi 280 të rinjë nga komuna e Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Ferizajit, Mitrovicës së Jugut, Lipjanit, Rahovecit, Dragashit, Fushë Kosovës, Graçanicës, Junikut, Klinës dhe Suharekës të cilët kanë kontribuar dhe përfituar në shumë aspekte nga këto debate duke filluar nga angazhimi i tyre, fitimi i njohurive dhe socializimi me të rinj të tjerë pjesëmarrës nga shkollat tjera.



Fig.18.Pamje gjatë aktivitetit 'Green Talks' në qytetin e Rahovecit





Fig.19.Pamje gjatë aktivitetit 'Green Talks' në qytetin e Gjiçanit



Fig.20 Pamje gjatë aktivitetit 'Green Talk' në qytetin e Gjakovës





Aktivizmi për të drejtat e njeriut

Fig.21. Seria e debateve "Green Talks"



Aktivizmi për të drejtat e njeriut



Fig.22 .Pamje gjatë aktivitetit 'Green Talks' në qytetin e Junikut



Fig.23 Pamje gjatë aktivitetit 'Green Talks' në Fushë Kosovë

Aksion Pastrimi



5.3. Aksion Pastrimi

Aksionet e pastrimit janë thelbësore për avokimin mjedisor dhe ruajtjen e mjedisit. EC realizon aksione të tilla pasiçë ato kanë një ndikim të madh në sensibilizimin e publikut dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përmes aksioneve të pastrimit me vullnetar dhe komunitetin arrihet ndërgjegjësimi mjedisor pasiçë të gjithë këto lloje të aktiviteteve kërkojnë angazhimin e komunitetit në këtë formë ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin e tyre në ruajtjen e mjedisit. Në të njejtën kohë mund të themi se përmes këtyre aksioneve ne mund të sjellim bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në aktivitete mjedisore.

Aksionet e pastrimit ndikojnë drejtpërdrejtë në pamjen e qyteteve dhe mjedisëve të tjera. Përmirësimi i estetikës urbane mund të ndikojë pozitivisht në perceptimin e njerëzve për mjedisin dhe mund t'i nxitë ata të jenë më të kujdesshëm ndaj tij.

Në përgjithësi, aksionet e pastrimit janë një mjet efektiv për të përmirësuar gjendjen e mjedisit dhe për të ndikuar në sjelljen e komuniteteve drejt praktikave më të qëndrueshme dhe përgjegjëse ndaj mjedisit.

EC përmes secilit aksion të realizuar u bënë thirrje institucioneve relevante dhe qytetarëve që të tregojnë më tepër kujdes dhe mirëmbajtje ndaj hapësirave publike.



Fig.24 .Pamje gjatë aksionit të pastrimit në Prizren

Fig.25 .Pamje gjatë aksionit të pastrimit në lagjen "Jeta e Re" . në Prizren



Fig.26 .Pamje gjatë aksionit të pastrimit në Prizren





Fig.27 Pamje gjatë aksionit në parkun e fëmijëve në Bazhdarhane në Prizren




Fig.28 Pamje gjatë aksionit të në rrugën për në Kallanë e Qytetit



Fig.29 .Pamje gjatë aksionit "Më hedh në shportë", Prizren



Punëtori dhe Vizionime





5.4. Punëtori dhe Vizionime

Në kuadër të projektit janë realizuar katër punëtori vizionimi nga të cilat kanë rrjedhur tre raporte vizionimi të hapësirave shkollore në bashkëpunim me nxënësit.

Metodologjia e punëtorive është e bazuar në planifikimin me pjesëmarrje, ku përmes përfshirjes aktive të nxënësve, si fillim është bërë shqyrtimi i gjendjes ekzistuese dhe është ideuar projekt propozimi për shtimin e një hapësire të re me qëllim të krijimit të një ambienti të jashtëm për mbajtjen e mësimi dhe aktiviteteve të ndryshme dhe vizionimi tjetër kishte të bëjë me krijimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara brenda në shkollë.

Punëtoritë janë zhvilluar përmes aktiviteteve të cilat janë zhvilluar pjesërisht në klasë dhe pjesërisht në ambientin e jashtëm të shkollës ku është menduar të realizohen intervenimet.

Gjatë këtyre punëtorive gjithmmonë prezantohet rëndësia e elementeve që do të

shtohen në kuadër të aktivitetit dhe nxënësit janë angazhuar për të punuar në mënyrë individuale dhe në mënyrë grupore duke kontribuar me idetë e tyre rreth vizionimit të hapësirave. Këto aktivitete kanë shërbyer poashtu edhe për inkurajimin dhe fuqizimin e nxënësve për aktivizimin dhe rolin e pjesëmarrjes së tyre në vendimarrje në komunitet.

Raportet e vizionimit në tjetrën anë do të shërbejnë si vlerë e shtuar për insitucionin si një hap i parë për investime në objektet shkollore, të cilat janë vizionuar bashkarisht me ta dhe kërkesat e vet nxënësve dhe stafit të shkollës.

Performanca Publike



5.5. Performanca Publike

Performancat publike janë të rëndësishme në avokimin për çështje në komunitet për shumë arsye. Këto performance janë një mjet efektiv për të ndërtuar transparencë, pjesëmarrje dhe besim në mes të komunitetit dhe organizatave që punojnë në të. Ata mund të përdoren si mjet strategjik për të përmirësuar jetën komunitare dhe avokuar për ndryshime pozitive

Përmes tyre mund të arrihet ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me çështjet që e proekupojnë komunitetin. Duke bërë shfaqjen e problemeve dhe duke bërë thirrje për zgjidhje të tyre, në këtë formë ne arrijmë të nxisim interesin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe të avokojmë në të njëjtën kohë për zgjidhje nga institucionet përgjegjëse.

Performancat e mira mund të shërbejnë si mjet për të mobilizuar komunitetin dhe nxitur pjesëmarrjen. Kur qytetarët shohin qëndrueshmëri dhe arritje në nivel lokal, ata mund të kenë më shumë besim dhe dëshirë për të angazhuar veten në iniciativat komunitare.

Në kuadër të projektit EC ka realizuar 11 performanca publike me anë të të cilave ka avokuar për mbrojtje të mjedisit dhe promovim të të drejtave të njeriut. Me anë të këtyre performancave për dy vite me rradhë është avokuar për krijimin e shtigjeve për biçikletave, është avokuar po ashtu për kujdesin dhe shtimin e gjelbërimit në hapësira publike dhe për eliminimin e shisheve të plastikës duke i zëvendësuar ato me shishe xhami. Një tjetër performance e realizuar ka pasur të bëjë edhe me mungesën e tualeteve publike në qytetin e Prizrenit.

Me anë të këtyre performancave janë shënuar edhe shume ditë mjedisore, si Dita e Tokës, Dita pa Makina ku është bërë thirrje për kujdes më të shtuar për mjedisin dhe po ashtu në bashkëpunim me organizatën OPDMK është shënuar edhe “Java e personave me Distrofi Muskulare” ku është avokuar për të drejtat e tyre, qasjen në hapësira dhe institucione publike dhe gjithëpërfshirjen e tyre.

Fig.31 .Pamje qiate aktivitetit Shumë makina e pak shtiqje për biçikleta





Fig.32Aktivitetet për ditën e tokës

Fig.33. Pamje gjatë aktivitetit për Ditën e Tokës





Fig.34. Pamje gjatë aktivitetit të Ditës Ndërkombëtare Pa Makina



Fig.57. Parakalimi Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e "Javës së Distrofisë"

Intervenime



5.6. Intervenime

Intervenimet direkte përbëjnë një mjet të rëndësishëm për të adresuar dhe zgjidhur sfidat dhe problemet në komunitet. Këto ndërhyrje përfshijnë veprime konkrete dhe të drejtpërdrejta për të përmirësuar situatën aktuale.

Përmes tyre realizohet zgjidhja e problemeve konkrete që i preokupojnë pjesëtarët e një komuniteti. Intervenimet direkte përdoren për të zgjidhur probleme specifike në nivel lokal. Përmes veprimeve të drejtpërdrejta, ne së bashku me qytetarët kemi adresuar nevojat e komunitetit.

Intervenimet direkte inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të komunitetit. Kur njerëzit janë të përfshirë në veprime të drejtpërdrejta për të përmirësuar situatën e tyre, ata ndjehen më të përfshirë dhe të përgjegjshëm ndaj gjithë procesit, në këtë formë ne kemi siguruar edhe qëndrueshmërinë e intervenimit.

Gjatë këtyre viteve në kuadër të projektit janë realizuar rreth 28 intervenime direkte në hapësira të ndryshme, gjatë këtyre intervenimeve janë realizuar intervenime artistike (murale) me mesazhe sensibilizuese, vendosja e dritave eficiente në ambiente shkollore, vendosja e ulseve, parkingjeve të biçikletave dhe janë mbjellur fidane drunore dhe bimë shumë vjeçare në hapësira të ndryshme në disa qytete të Kosovës.



Fig.35. Pamje pas vendosjes se tabelave



Fig.37. Intervenimet e gjelbra nga EC



Fig.38 Intervanimi për hapësira më të shfrytëzueshme në ShFMU "Nazim Kokollari" në Prizren

Fig.39 Kontribujimin në përmirësimin e hapësirave në shkollat e Komunës së Lipjanit





Fig.40 Dita Botërore e Shpendëve Tregatr



Fig.41 Aktiviteti me nxënësit e Qendrës
Burimore për Mësim dhe Këshillim "Lef Nosi"

Fig.42 EC shënon Ditën e Tokës





Fig.43 Intervenime me LED llamba eficiente në ShFMU "Nefit Jusufi"

Fig.44 EC shënon Ditën e Tokës



Shkolla e aktivizimit





5.7. Shkollat e aktivizmit

EC Ma Ndryshe ka realizuar tre shkolla të aktivizmit në komunitet me 90 të rinjë nga komuna e Prizrenit, Rahovecit, Malishevës, Suharekës, Dragashit, Deçanit, Gjakovës, Pejë, Ferizajt, Gjiçanit, Hanit të Elezit, Kamenicës dhe Kaçanikut. Kjo shkollë ka për qëllim aftësimin e të rinjve si dhe t'iu ofrojë atyre një përvojë unike të aplikimit të dijeve të fituara në praktikë. Përgjatë saj të rinjtë kanë patur mundësinë që përmes ligjëratave dhe punëtorive të organizuara, të angazhohen lidhur me tema të ndryshme.

Bashkë me ligjëruesit, trajnerët dhe mentorët, pjesëmarrësit përmes detyrave të dhënave diskutuan rreth problemeve mjedisore më të mëdha me të cilat ballafaqohet vendi ynë, si dhe përmes shembujve konkretë, ata propozuan zgjidhje për përmirësimin e kësaj situatë.

Poashtu, ata patën mundësinë që të mësojnë edhe rreth të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me theks të veçantë rreth të drejtës për qasje në dokumente/informacione publike, si dhe rreth strukturave përfaqësuese rinore dhe avokimin për çështjet rinore.

Të rinjtë po ashtu mësuan dhe diskutuan më tepër rreth aktivizmit si formë të mobilizimit për formësim urban dhe mjedisor si dhe rreth dizajnit të ciklit të një projekti, pastaj rreth hapave të realizimit të një projekti, pasi të gjithë pjesëmarrësit kanë aplikuar në shkollë me një ide të tyre të cilën ata e shohin të nevojshme ta realizojnë për të mirën e komunitetit.

Për përpunimin e këtyre ideve fillestare të tyre, pjesëmarrësit janë asistuar nga trajnerët dhe mentorët përmes punëtorive dhe punës në grupe.

Fokus në këto shkolla i është kushtuar ndërgjegjësimit të të rinjve dhe nxitjes së aktivizmit të përbashkët përmes parimeve bazë të gjithëpërfshirjes, zhvillimit të qëndrueshëm, promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut e deri në mbrojtjen e mjedisit, të elaboruara përmes shembujve e rasteve nga praktika.

Fig.46 EC Ma Ndryshe ka realizuar aktivitetin tre ditor "Shkollën e Aktivizmit në Komunitet".



Fig.4.7 EC Ma Ndryshe ka realizuar aktivitetin tre ditor "Shkollën e Aktivizmit në Komunitet".



Gara mjedisore



5.8. Gara mjedisore

Realizohet ideja fituese e garës mjedisore

EC Ma Ndryshe ka realizuar tre gara mjedisore me të cilat ka synuar të pasqyrojë kontributin e të rinjve për mbrojtjen, parandalimin e degradimit të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

Gara e parë “Unë mund ta mbroj mjedisin dhe t’i parandaloj ndryshimet klimatike” ka qenë e hapur vetëm për shkollat e mesme të larta në qytetin e Prizrenit. Në këtë garë kanë aplikuar gjithsejtë 8 grupe të nxënësve dhe janë ndarë tre çmime të para. Ideja e vendit të parë është shpërblyer me një shumë financiare prej 1,000 euro, e cila është përdorur për realizim të asaj ideje.

Gara e dytë “Ndrysho sjelljen dhe jo klimën” ka qenë e hapur për të gjitha shkollat e mesme të larta në Kosovë. Në këtë garë kanë aplikuar gjithsejtë 19 grupe të nxënësve dhe janë ndarë tre çmime të para. Ideja e vendit të parë është shpërblyer me një shumë financiare prej 1,000 euro, e cila është përdorur për realizim të asaj ideje.

Dhe gara e tretë “Ti sidojmë ndryshimet klimatike” ka qenë e hapur për të gjitha shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta në Kosovë. Në këtë garë kanë aplikuar gjithsejtë 71 grupe të nxënësve ku ideja më e mire është shpërblyer me një shumë financiare prej 2,400 euro, e cila është përdorur për realizim të asaj ideje.

Nxënësit apo grupet e nxënësve të shkollave pjesëmarrëse në garë duhet të dërgojnë nga një propozim për intervenim, duke e përshkruar idenë sipas kriterëve të kërkuara në thirrje dhe në dokumentacionin e bashkëngjitur më poshtë.

Idetë dhe propozimet për intervenime të shkollave pjesëmarrëse në garë kanë prekur temat e: mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së Biodiversitetit, menaxhimit të mbeturinave, ndotjes së ajrit dhe mekanizmat për mbrojtjen e ajrit, ndotjes së ujërave dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre, dhe rritjen e hapësirave të gjelbra në hapësirat e shkollës dhe komunitetit përreth.





Fig.48 Realizimi i idesë fttuese të garës



Fig.49 THIRRJE PËR GARËN: "Unë mund ta mbroj mjedisin dhe t'i parandaloj ndryshimet klimatike"



Fig.50 T'i sfidojmë ndryshimet klimatike"



Storjet e
suksesit



6.0.Storjet e suksesit

INTERVENIMET DIREKTE DHE PERFORMANCAT PUBLIK

Janë realizuar rreth 28 intervenime direkte në hapësira të ndryshme, gjatë këtyre intervenimeve janë realizuar intervenime artistike (murale) me mesazhe sensibilizuese, vendosja e dritave eficiente në ambiente shkollore, vendosja e ulseve, parkingjeve të biçikletave dhe janë mbjellur fidane dhe bimë shumëvjeçare në hapësira të ndryshme në disa qytete të Kosovës.

Këto intervenime janë realizuar në bashkëpunim edhe me partnerë të tjerë duke rritur kështu bashkëpunimin dhe angazhimin e shumë akterëve në mënyrë që këto intervenime të kenë sa më shumë qëndrueshmëri.

Gjatë këtyre aktiviteteve janë angazhuar 247 të rinjë, ku së bashku me ta përveç aksioneve të pastrimit dhe intervenimeve tjera në mobiliar, eficientë dhe artistike, janë gjelbëruar edhe shumë hapësira publike me gjithsejtë 1974 fidane drunore dhe bimëve shumë vjeçare.

Aktivizmi për të drejtat e njeriut



Fig.50 3 shkolla të aktivizmit me 90 të rinjë pjesëmarrës nga 14 komuna







Harta e iniciativave

7.0.Harta e Inicativave

1. Takim me Kuvendin e të rinjve , Lipjan
2. Takim me nxënësit shkollës SHML "Remzi Ademaj" dhe SHML "Ymer Prizreni" , Prizren
3. Takim me nxënësit shkollës së mesme të lartë teknike "11 Marsi" , Prizren
4. Takim me të rinjtë , Ferizaj
5. Takim virtual me të rinjtë , Lipjan
6. Takim virtual me të rinjtë e shkollës fillore të mesme të ulët "Anadolu", Mamushë
7. Takim virtual me nxënësit e shkollës fillore të mesme të ulët "Emin Duraku" , Prizren
8. Takim me nxënësit dhe stafin e ShMU "Mazllum Këpuska" , Gjakovë.
9. Takim virtual me nxënësit e shkollve fillore dhe të mesme , Gjakovë.
10. Takim virtual me me përfaqësues të ShFMU "Kadri Beba", "Ernest Koliqi", "Skënderbeu" "Shtjefën 11. Gjeqovi" dhe "Fehmi Agani".
12. Takim përfaqësuesit nga Ambasada e Suedisë në Kosovë , Prizren
13. Takim virtuale me të rinjtë , Lipjan
14. Takim me zyrtarët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike , Prizren
15. Takim me Kuvendin e të Rinjve , Prizren
16. Takim dhe aktivitet me të rinjtë , Suharekë
17. Takime me institucionet dhe OJQ-të, përfshirë me Kryesuesen e Kuvendit të Komunës - Prizren , OJQ-në "HandiKos" dhe Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nënë Tereza" , Prizren.
18. Takimi me të rinjtë , Deçan
19. Takimi me të rinjtë , Istog
20. Takime me institucionet dhe OJQ-të , Klinë si dhe me përfaqësues të OJQ-së "HandiKos".
21. Takim të rinjtë , Gjakovë
22. Takime me OJQ të ndryshme , Prizren, Rahovec.
23. Green Talks – Biseda të gjelbra , Prizren
24. Green Talks – Biseda të gjelbra , Pejë
25. Green Talks – Biseda të gjelbra , Suharekë
26. Green Talks – Biseda të gjelbra , Mitrovicë
27. Green Talks – Biseda të gjelbra , Ferizaj
28. Green Talks – Biseda të gjelbra , Gjakovë
29. Green Talks – Biseda të gjelbra , Lipjan
30. Green Talks – Biseda të gjelbra , Rahovec
31. Green Talks – Biseda të gjelbra , Dragash
32. Green Talks – Biseda të gjelbra , Gjilan
33. Green Talks – Biseda të gjelbra , Kline
34. Green Talks – Biseda të gjelbra , Junik
35. Green Talks – Biseda të gjelbra , Graçanicë

36. Green Talks – Biseda të gjelbra , Fushë Kosovë
37. Aksion për pastrimin e qytetit , përkatësisht disa hapësira në lagjen Lakuriq , Prizren
38. Aksion për pastrimin e qytetit , Prizren
39. Aksion për pastrim përgjatë rrugës “5 Maji” në lagjen “Jeta e Re”, Prizren
40. Aksion për pastrim përgjatë rrugëve “Reshat Karjagdiu” dhe “Nazim Pulaj”, Prizren
41. Aksion për pastrim në stacionin e trenit , Prizren
42. Aksion për pastrim në rrugën për në Kalanë e Qytetit , Prizren
43. Aksion për pastrim në bashkëpunim me Qendrën Burimore “Lef Nosi” në parqet-hapësirat publike të lagjes Lakuriq , Prizren.
44. Aksion për pastrim në parkun e fëmijëve në Bazhdarhane , Prizren
- 45 . “Më hedh në shportë”, aksion pastrimi në parkingun dhe parkun mbrapa Shtëpisë së Bardhë , Prizren
46. Vizualizim për klasës verore në SHFMU “Fadil Hisari” , Prizren
47. Performancë publike për sensibilizimin e qytetarëve për shmangien e përdorimit të makinave , Prizren
48. Thirrje për kujdes të shtuar ndaj mjedisit për Ditën e Tokës , Prizren
49. “Qytetet funksionale”, pa tualete publike performancërreth mungesës së tyre në hapësira publike , Prizren
50. Aktivitet “Pedalo për Ditën Ndërkombëtare Pa Makina” në bashkpunim me OJQ “Lidhja Vëzhguesve Rinia e Kosovës” dhe OJQ “Pro Bike – Prizren” , Prizren
51. “Dita Pa Makina” , Prishtinë dhe Prizren
52. Aktiviteti “Zëvendëso plastikën, mbroje mjedisin” bashkë me përfaqësues të Ambasadës Suedeze , Prizren
53. Aktivitete për “Javën e Distrofisë Muskulare” në bashkpunim me OPDMK , Prizren
54. Parakalimi bashkë me PAK-të në kuadër të aktivitetit për “Javën e Distrofisë Muskulare” , Prizren
55. Aktivitete të ndryshme për Ditën e Tokës bashkë me Klubin e Gjelbër të shkollës “Pjetër Bogdani” , Prishtinë
56. Aktivitete në bashkpunim me OPDMK “ Ne mundemi” , Prizren
57. Vendosja e tabelave informuese rreth rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin drunjtë për mjedisin e pastër në zonat urbane , Prizren
58. Intervenime të gjelbra në Lagjen Lakuriq , Prizren
59. Intervenime të gjelbërta , Prishtinë
60. Intervenime të gjelbërta në rrugën “Alpet Shqiptare” , Prizren

61. Intervenime të gjelbërta në hapësira publike në rrugën "Ankara"-Lagjja Bazhdërhane , Prizren
62. Vendosja e shtëpizave të drurit për zogj në Ditën Botërore të Shpendëve Shtegtarë , Gjakovë
63. Vendosja e folesë për lejlekë në njëren prej shtyllave në rrugën "Besim Shala" , Prizren
64. Kontribim në përmirësimin e hapësirave në shkolla , Lipjanit
65. Intervenimi për hapësira më të shfrytëzueshme në ShFMU "Nazim Kokollari" ,Prizren
66. Intervenimi me LED llamba eficiente në ShFMU "Nefit Jusufi" , Skorobishtë ,Prizren
67. Aksioni i mbjelljes së druve dekorativë në lagjen Lakuriq ,Prizren
68. Intervenimi me mbjelljen e fidanëve në Sheshin "Gëzim Pepshi" , Junikut
69. Intervenimi "Ripërdor dhe krijo" - ulëse dhe tavolina të improvizuara nga druri dhe plastika , Gjakovë
70. Intervenime shumëgjyreshe në trungjet e parkut të qytetit , Prizren
71. Intervenimi artistik "Zgjimi i tingujve" , Prizren
72. Vendosja e ulëseve eko-miqësore në Qendrën Historike , Prizren
73. Intervenimi me mbjellje në këndin e lojërave të lagjes "Bajraktar" , Junik
74. Intervenimi artistik "Të drejta të barabarta dhe gjithëpërfshirja" , Rahovec
75. Aktivitet me nxënësit e Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim "Lef Nosi" , Prizren
76. Intervenimi artistik "Lundrimi në kolltuk" , Suharek
77. Intervenimi artistik "Mbroj dhe promovoj" , Prizren
78. Intervenimi artistik "Protect & Promote" , Prizren
79. Intervenimi me mbjellje të drunjëve në hapësirën publike afër Parkut të Ri , Gjakovës
80. Intervenimi me gjelbërim dhe ulëse në hapësirat publike përgjatë rrugëve "Eqrem Çabej" dhe "Bingeni", në lagjen Ortakoll , Prizren
81. Intervenimi me mbjellje në oborrin e Shkollës së Mesme të Lartë "Ruzhdi Berisha" dhe në oborrin e QKMF-së "Adem Berisha" , Dragash
82. Intervenimi me mbjellje të drunjëve në lagjen Bazhdarhane , Prizren
83. Aktivitet tre ditor i shkollës së aktivizimit në komunitet , Deçan, Gjakovë, Pejë dhe Prizren
84. Aktivitet tre ditor i shkollës së aktivizimit në komunitet , Prizren, Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Suharek dhe Dragash

85. Aktivitet tre ditor i shkollës së aktivizimit në komunitet , Ferizaj , Gjilan , Hani i Elezit, Kamenicë, Kaçanik dhe Prizren


86. Intervenimi fitues i garës mjedisore të titulluar : “Unë mund ta mbroj mjedisin dhe t’i parandaloj ndryshimet klimatike” , Prizren

87. THIRRJE PËR GARËN: “Unë mund ta mbroj mjedisin dhe t’i parandaloj ndryshimet klimatike” , Prizren

88. Realizimi i idesë fituese i garës mjedisore “Ndrysho sjelljen dhe jo klimën” , Ferizaj

89. Gara “T’i sfidojmë ndryshimet klimatike” , Obiliq

HARTA E INICIATIVAVE



LISTA E INICIATIVAVE

- PRIZREN 48
- LIPJAN 6
- FERIZAJ 4
- GJAKOVË 10
- SUHAREKË 4
- DEQAN 1
- ISTOG 1
- KLINË 2
- RAHOVEC 5
- PEJË 2
- MITROVICË 1
- DRAGASH 3
- GJILAN 2
- JUNIK 3
- GRAÇANIC 1
- FUSHË KOSOVË 1
- PRISHTINË 3
- MALISHEVË 1
- HANI I ELEZIT 1
- KAMENICË 1
- KAÇANIK 1

Konkluzione dhe rekomandime

Udhëzuesi "HUMAN RIGHTIVISM – aktivizmi për të drejtat e njeriut", jep këto rekomandime:

Për institucionet arsimore të nivelit qendror dhe lokal, organet qeverisëse në Komunitatet e Kosovës dhe për të rinjtë:

- Mundësimi i aktivizmit mjedisor të të rinjëve dhe promovimi, vullnetarizmi dhe përfshirja e të drejtave mjedisore dhe të drejtave të njeriut në iniciativat rinore;
- Angazhimin në gjetjen e modaliteteve për nxitjen e aktivizmit dhe vullnetarizmit në mesin e të rinjëve dhe komunitetit;
- Ofrimin e mundësive të përfshirjes së të rinjëve në projekte dhe aktivitete mjedisore;
- Angazhimin e të rinjëve në gara të ndryshme mjedisore që kanë për qëllim aktivizimin dhe vetdijësimin e të rinjëve;
- Ofrimin e diskutimeve të hapura në kuadër të "Green Talks" ;
- Angazhimin e të rinjëve në aktivitete jashtë kurrikulare;
- Promovimin e aktivizmit dhe vullnetarizmit të komuniteteve në hapësirat publike apo të banimit;
- Gjetjen e modaliteteve për përfshirjen e komunitetit në nisma sa i përket të drejtave të njeriut;
- Angazhimin e të rinjëve në nisma të aktivizmit dhe vullnetarizmit në baza të rregullta vjetore;
- Përfshirjen e të rinjëve në diskutime publike të cilat kanë për qëllim aftësimin e të rinjëve si dhe t'iu ofrojë atyre një përvojë unike të aplikimit të dijeve të fituara në praktikë;
- Angazhimin vullnetar në të mirë të komunitetit;
- Përfshirjen në situata vendimmarrëse, diskutime publike dhe ngjarje me interes për të ardhmen e komunitetit;
- Promovimin e performancave publike me qëllim të përfshirjes së komunitetit në iniciativa vendimmarrëse;
- Adresimin e pakompromis të shqetësimeve, kërkesave dhe ideve të tyre në institucione relevante;
- Ofrimin e intervenimeve të ndryshme në hapësira publike me qëllim përfshirjen e komunitetit në interes të tyre;
- Fokusi në veprimin mbi klimën, inovacionin dhe avokimin i politikave;
- Edukimi mjedisor dhe fuqizimi i të rinjëve.

Për EC

EC ma ndryshe

EC Ma Ndryshe EC është organizatë e komunitetit, e themeluar ne vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithë përfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mire (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes). EC angazhohet për qytete/ komuna gjithë përfshirëse në Kosovë. Organizata beson në vlerën e shtuar që sjell angazhimi i gjithësecilit në qeverisjen e qyteteve/ komunave dhe në veçanti e atyre që kanë më pak qasje dhe mundësi për të ndikuar. Në punën e saj 13 vjeçare EC është fokusuar në mobilizimin e komunitetit duke u dhënë prioritet grupeve të nën përfaqësuar. Ky angazhim e ka vendosur EC-in në krye të organizatave të komunitetit në Kosovë. Një nga metodologjitë dalluese të EC-it është ajo e planifikimit urban me pjesëmarrje, rezultatet e së cilës janë tejet të prek shme në komunën e Prizrenit. Për shumë qytetarë të Prizrenit, por edhe për disa lokacione të tjera në

Kosovë, EC shihet si adresë shumë kredibile për çuarjen tutje të nevojave, kërkesave dhe interesave komunitare. EC ka punuar dhe vazhdon të punëojë ngushtë me PAK, të moshuarit, grate dhe vajzat, banorët e lagjeve informale, komunitetet jo shumicë, artistët, ambientalistët dhe shumë të tjerë në baza ditore në përpjekjen e përbashkët për t'i kthyer nevojat e qytetarëve në vendime e veprime të institucioneve. Në të njëjtën kohë, EC ka ndërtuar grupe lokale të komunitetit në nivel të lagjes dhe fshatit në komunën e Prizrenit, ndërsa nga viti 2018 këtë praktikë po e bart edhe në komunat e tjera të Kosovës (deri në 2020 synohet zgjerimi deri në dhjetë komuna). Përveç angazhimit komunitar, EC njihet edhe për avokimin konsistent në mbrojtje të strukturës urbane të qyteteve të Kosovës, me fokus në vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Përmes rrjetit të gjerë të profesionistëve me të cilët bashkëpunon në baza të rregullta, EC ka zhvilluar standard të larta të cilësisë sa i përket shërbimeve që i ofron dhe produkteve që i realizon. Organizata ka qenë dhe vazhdon të jetë kontribuese e drejtpërdrejtë e hartimit të një numri të konsiderueshëm politikash publike në nivel qendror dhe lokal. Në të njëjtën kohë, EC ka prezencë të shtuar edhe rajonale dhe ndërkombëtare përmes mekanizmave të rëndësishëm të rrjetëzimit profesional dhe të shoqërisë civile.